

Informacion rreth jurisprudencës nr. 196 të Gjykatës

maj 2016

Džinić kundër Kroacisë - 38359/13

Vendim 17.5.2016 [Seksioni II]

Neni 1 i Protokollit nr. 1

Neni 1 para. 2 i Protokollit nr. 1

Kontrolli dhe përdorimi i pronës

Urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të pasurisë në një proces penal pa vlerësim të proporcionalitetit të masës: *ka shkelje*

Faktet – Kërkuesi, drejtor i një kompanie, u vu nën hetim bazuar në dyshimin për kryerjen e krimeve ekonomike. Gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë miratoi një kërkesë nga Prokuroria e Shtetit për sekuestrimin e disa prej pronave të kërkuesit, me qëllim që të sigurohej ekzekutimi i një urdhri të mundshëm konfiskimi që mbulonte fitimin monetar që ai pretendonte se kishte nxjerrë nga krimi ekonomik i pretenduar. Urdhri i sekuestrimit u la në fuqi nga Gjykata e Lartë. Kërkesa e kërkuesit që masa të hiqej ose të rivlerësohej me arsyetimin se vlera e pronave të sekuestruara tejkalonte shumë e fitimit të pretenduar monetar u hodh poshtë nga gjykata.

Baza ligjore – Neni 1 i Protokollit nr. 1: Çështja e vetme përpara Gjykatës ishte nëse sekuestrimi i pronave të kërkuesit ishte proporcional, me fjalë të tjera, nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit.

Kërkuesi dyshohej se kishte nxjerrë një fitim monetar prej afërsisht 1,060,000 euro përmes kryerjes së veprave penale. Për rrjedhojë, veprimi i ndërmarrë nga Prokuroria e Shtetit për të siguruar zbatimin e një urdhri të mundshëm konfiskimi nuk ishte në vetvete i hapur për kritika. Megjithatë, duke pasur parasysh rrezikun e një barre të tepruar që i ngarkohej kërkuesin, kjo nuk i çlironte gjykatat e brendshme nga konstatimi nëse ishin plotësuar kushtet për sekuestrimin e pronave të tij dhe nëse natyra dhe shtrirja e sekuestrimit ishin proporcionale. Pavarësisht se nuk kishte prova përpara saj në lidhje me vlerën e pronave, gjykata e shkallës së parë kishte pranuar kërkesën për sekuestrimin e të gjitha pronave pa bërë asnjë vlerësim të proporcionalitetit midis vlerës së tyre dhe shumës së fitimit të pretenduar. Gjykata e Lartë nuk e kishte korrigjuar atë mosveprim duke mos bërë vlerësimin e vet të proporcionalitetit dhe më vonë kishte hedhur poshtë pretendimet e kërkuesit në proces penal se pronat në fakt kishin vlerë pothuajse 10,000,000 euro duke i vlerësuar ato si spekulative pa dhënë arsye. Gjykata e konsideroi të rëndësishme të theksohej se pronat nuk pretendoheshin të ishin rezultat i krimit ose të gjurmueshme nga krimi. Megjithatë, pronat kishin mbetur subjekt i urdhrit të sekuestrimit për më shumë se dy vjet e gjysmë.

Me pak fjalë, edhe pse në parim legjitim dhe i justifikuar, sekuestrimi ishte vendosur dhe mbajtur në fuqi pa një vlerësim nëse vlera e pronave të sekuestruara korrespondonte me pretendimin e konfiskimit të mundshëm. Për rrjedhojë, mënyra se si ishte zbatuar masa,

nuk ishte e përshtatshme për të demonstruar se ishte përmbushur kërkesa e "baraspeshës së drejtë".

Përfundim: ka shkelje (me unanimitet).

Neni 41: 2000 euro për dëm jopasuror; Kërkesa në lidhje me dëmin material është hedhur poshtë.

Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane për të Drejtat e
Njeriut

Kjo përmbledhje e Sekretarisë nuk është detyruese për
Gjykatën

Klikoni këtu për më shumë informacion rreth
[Case-Law Information Notes](#)